



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**KESHILLI BASHKIAK**

Proces-verbal

**A. Të dhëna të përgjithshme**

Takimi publik për konsultimin e prezantimit :Plani vendor i Arsimit Parauniversitar

Data e takimit: 26.08.2025

Vendi i takimit: Salla e mbledhjeve Bashkia Elbasan

Ora e hapjes së takimit: 10:30

Kryesuesi i takimit: Evis Stafa,Jonida Cungu

Këshilltarë pjesëmarrës në takim, nr 1

Emri:Altin Meçja

Anëtarë të Komisionit të Përherershëm te Arsimit

Nr 1 Emri: Altin Meçja

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim, nr 8

Anëtarë të strukturave komunitare pjesëmarrës në takimi, nr 4

Emrat-Ervis Cota;Kristina Kreka;Nadire Kreka;Arjola Tashi

Pjesëmarrës në takim nga komuniteti: nr 4

Nga te cilet vajza/gra: nr 10

**B. Zhvillimi i takimit.** Znj Jonida Cungu-Bën Prezantimin.Qëllimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar është garantimi i një shërbimi arsimor cilësor,gjithëpërfshirës dhe i barabartë për të gjithë fëmijët dhe nxënësit,përmes sigurimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe kapaciteteve menaxhuese të institucioneve arsimore,ngritjes së mekanizmave funksionalë për cilësinë,transparencën dhe llogaridhëni,si dhe nxitjes së zhvillimit social e kuror të nxënësve përmes mbështetjes me veprimtari.Bashkia Elbasan ka në administrim 134 objekte arsimore të ndara në kopshte, shkolla te arsimit bazë, shkolla të mesme të përgjithshme,të bashkuara dhe sholla profesionale.Ky plan parashikon dhe planifikon nevojat arsimore të komunitetit në nivel lokal;kordinon burimet njerëzore dhe infrastrukturore;ndihmon në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes krijimit të kushteve fizike falë investimeve;siguron përfshirje gjithëpërfshirëse dhe barazi në arsim;mbështet rritjen e aksesit në arsim cilësor.Shpjegohen qëllimet e politikave strategjike lokale ,objektivat dhe aktivitetet

kryesore për arsimin parashkollar (3-6 vjec), aktivitetet për arsimin bazë dhe atë të mesëm e profesional.

C.

D. Folësi -.Nadire Kreka.

Komente/Rekomandime Tek plani social që është bërë kemi menduar që qendrat komunitare të jenë brenda shkollave.Në një klasë të jetë një mësues që të mësojë nxënësit e ti ndihmojë me dëtyrat në zonat rurale.

Kristina Kreka

Komente/Rekomandime Tek plani i aktiviteteve të shtohen jo vetëm Bashkia ZVA por edhe forumet,organizatat

Folësi -Ervis Çota

Komente/Rekomandime-Edhe mësuesit që punojnë ekstra tek qendrat komunitare kanë një ngërç tek kalimi i pagave plus ata kanë një pagë shumë të ulët.Duhet bër një vlerësim i nevojave që kanë nxënësit pra **Identifikimi i nevojave të nxënësve**.Duhet përshtatur edhe mësuesit sipas lëndëve.

Folësi-Jonida Cungu.

Projektin bëjmë detyrat ta çojmë edhe në fshat ,nxënësit të bëjnë kurse gjuhe të huaja,matematikë,gjuhë pra lendët thelbësore.Mësuesit duhet të punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta.Duhet punuar edhe ekstra jashtë orarit të shkollës.

Folësi -Suela

Komente/Rekomandime Edhe për mësuesit bëhet mirë që ti plotësojnë normat dhe orët mësimore

Folësi - Ervis Çota

Komente/Rekomandime Duke qenë se Elbasani është në projektin Green (Shkollë e Gjelbër) janë 7 shkolla që është bër studimi i pilotimeve.Është e nevojshme të zhvillohen aktivitete në shkollat e gjelbërtë pasi krijohen modele që shkollat të mësojnë ta marrin energjinë Green e jo të paguajnë faturat elektrike.

Folësi – Nadire Kreka

Terminologjia,ky plan të shprehet në gjuhë gjinore .

Folësi - Ervis Çota

Komente/Rekomandime.Të rritet buxheti për rikonstrukcionin e shkollave pasi çmimet janë rritur dhe duhet rritur edhe buxheti.

Mbyllja e takimit. Ora 11:30

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

  
Alba Papa